




Sistemi i subvencioneve në Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prishtinës Versioni 1.2

Appdec

Maj 2017

Contents


1. HYRJE	3
1.1. Navigimi	3
2. APLIKANTI	5
2.1. Regjistrimi	5
2.2. Konfirmimi dhe plotësimi i profilit	6
2.3. Kyçja	9
2.4. Rivendos fjalëkalimin	9

1. HYRJE

Dokumenti në vijim do të shërbej si udhëzues për përdorimin e aplikacionit. Aplikacioni do të shërbej për publikimin e thirrjeve për aplikim, në faza të ndryshme vjetore. Do të mundësoj krijimin e tri llojeve të llogarive: individuale, biznesore dhe të OJQ-së. Aplikacioni është i shfrytëzueshëm në dy gjuhë: shqip dhe serbisht, si dhe do të mundësoj aplikim dhe vlerësim online. Do të ketë edhe kalendarin e aktiviteteve ku do të publikohen të gjitha aktivitetet e aplikacioneve fituese.

1.1. Navigimi

Banorët do të kenë mundësi që të navigojnë në **Ballinë** (nr.1) ku kanë mundësi të shohin thirrjet për aplikim. Ata mund të shohin titullin e thirrjes (nr. 1.1), i cili njëkohësisht shërben edhe si navigues për të parë përshkrimin më të detajuar të thirrjes. Mund të shohin përshkrimin e shkurtër të thirrjes (nr. 1.2), mund të shohin dhe shkarkojnë dokumentin i cili është bashkangjitur me thirrjen (nr. 1.3), mund të shohin datën e fillimit dhe datën e mbarimit për aplikim në thirrjen përkatëse (nr. 1.4), dhe varësisht datës së aplikimit mund të shfaqet, apo mos shfaqet butoni për aplikim. Nëse data e fillimit të aplikimit është data aktuale apo e mëhershme se data aktuale, do të shfaqet butoni APLIKO (nr. 1.5), nëse data e fillimit të aplikimit nuk ka arritur akoma, butoni APLIKO nuk do të shfaqet në thirrje (nr. 1.6).




The screenshot displays the web application interface for the Municipality of Prishtina. At the top, there is a navigation menu with links: KOMUNA E PRISHTINËS, BALLINA (1.), LEGJISLACIONI (2.), KALENDARI (3.), and KONTAKTI (4.). On the right, there are links for Shqip (5.), Regjistrimi (6.), and Kycja (7.). The main banner features the text "MIRËSEVINI NË SISTEMIN E MENAXHIMIT TË GRANTEVE KULTURORE" and "E PRISHTINËS NA PRISHTINA CITY OF PRISHTINA". Below the banner, the section "1.1 THIRRJE PËR PROJEKTE NË SEKTORIN E KULTURËS" is visible. It includes a description of the call for projects, a list of documents (1.3) with a download icon, a date range (1.4) "22.05.2017 10:28 - 24.05.2017 10:28", and an "APLIKO" button (1.5) with a right arrow icon. A red box highlights the "1.6" section "THIRRJE PËR PROJEKTE RINORE", which contains a description of the call for projects, a list of activities (Promovimi i Vullnetarizmit, Integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara), a document "Chrysanthemum.jpg" (1.3), and a date range "25.05.2017 11:31 - 27.05.2017 11:31".

Figura 1 - Navigimi i përdoruesit

Legjislacioni (nr. 2) do të përmbajë përshkrim, ligje, dokumente të cilat ndërlidhen me këtë aplikacion. Dokumentet që gjenden në këtë pjesë do të kenë mundësi të shkarkohen.

Kalendari (nr. 3) do të shfaqë aktivitetet e projekteve fituese, ku pasi të klikoni mbi cilindro aktivitet që dëshironi, do të keni mundësi të shihni titullin, përshkrimin, lokacionin, datën e fillimit dhe mbarimit të aktivitetit si dhe nëse ka ndonjë ueb faqe apo rrjet social të bashkangjitur.



KOMUNA E PRISHTINËS | BALLINA | **KALENDARI** | LEGJISLACIONI | KONTAKTI

Shqip - Regjistrimi | Kyçja

KALENDARI

KALENDARI KULTUROR I AKTIVITETEVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Të gjitha aktivitetet kulturore të cilat do të organizohen në Prishtinë nga Komuna e Prishtinës, institucionet vartëse të saj dhe institucionet tjera të Prishtinës mund t'i gjeni në këtë faqe sipas muajve.

Maj 2017

Hen Mar Mer Enj Pre Sht Dia

1 2 3 4 5 6 7

8 9 10 11 12 13 14

15 16 17 18 19 20 21

22 23 24 25 26 27 28

29 30 31

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11

Projekti:
AENEAN A DICNISSIM EX, NEC ECESTAS VELIT. AENEAN SIT AMET ULLAMCORP ER TORTOR.

Përshkrimi: Integer sollicitudin interdum nisi. eget faucibus est hendrerit eu. Pellentesque vel eleifend nibh. Proin elit tellus, tristique nec scelerisque ac, consectetur sed purus. Suspendisse suscipit risus sit amet enim volutpat consequat. Cras sed tellus a justo pharetra eleifend. In fella fella, ultrices quis imperdiet a, rhoncus ut mauris. Nullam imperdiet vitae purus eu auctor. Fusce id dui sed urna fermentum ultricies eu ut tellus. Duis eget condimentum leo. Pellentesque mattis arcu sem, nec semper

Prishtine
24.5.2017 - 27.5.2017
www.appdec.com

Close

Kontakti (nr. 4) do të jetë një faqe ku do të mundësohet kontaktimi me administruesit e ueb-faqës për ndonjë problem teknik, apo informatë shtesë.

Përdoruesit e ueb-faqës kanë mundësi të përdorin atë në dy gjuhë (nr. 5): shqip, apo duke klikuar mbi gjuhën shqipe ku do të shfaqet edhe gjuha serbe për ta ndryshuar.

Në menu mund të gjeni edhe butonin **Regjistrimi** ku mund të klikoni për tu regjistruar nëse nuk keni llogari të krijuar (nr. 6), apo nëse keni llogari të krijuar tashmë, klikoni në butonin **Kyçja** (nr. 7)

2. APLIKANTI

Nëse aplikuesi nuk ka llogari të krijuar ai duhet të klikoj në menu **Regjistrimi** (Fig. 1), apo duke klikuar te **Kyçja** (Fig. 1), ku duhet klikuar në butonin *KRIJO LLOGARI TË RE* (Fig.2, nr.1).




Figura 2 - Kyçja

2.1. Regjistrimi

Pasi banori të ketë klikuar për të krijuar llogari të re, do të hapet faqja si në Figurën 3.

Të gjitha fushat që janë në ueb-faqe kanë nga një informatë më të detajuar nëse vendoset kursorin mbi ikonën .


Emri personal.
* Emri 

Aplikuesi duhet të plotësoj të gjitha fusha te obligueshme, të cilat identifikohen me nga një yll (*) përpara. Duhet pasur kujdes që numrin personal të shkruhet sakët, pasi që nuk ipet mundësia të ndryshohet më.

Me një E-mail adresë mundësohet krijimi i një llogarie, pra llogari individuale, biznesore apo OJQ (Organizatë Jo Qeveritare).

Fjalëkalimi i cili vendoset rekomandohet të mos jetë i njëjtë me atë të E-mail adresës, si dhe duhet të përmbajë së paku 8 karaktere, të kombinuara me shkronja dhe numra.

Pasi plotësimi të të gjitha të dhënave duhet klikuar butonin Krijo llogarinë.



REGJISTRIMI

KRIJIMI I LLOGARISË

* Emri * Mbiemri

* Numri personal

Ju lutem shkruani numrin personal. Pas kalimit të kësaj faze të regjistrimit nuk do të lejohet ndryshimi i numrit personal!

* Zgjedh llojin e llogarisë ☒ Individual ☐ OJQ ☐ Biznes

* E-maili i llogarisë

* Fjalëkalimi

Fjalëkalimi duhet të përmbajë shkronja, numra dhe duhet të ketë së paku 8 karaktere. Rekomandohet të mos përdoret fjalëkalimi i njëjtë sikur i E-mail adresës suaj personale!

* Konfirmo fjalëkalimin

Fushat me * janë të obliguara!

KRIJO LLOGARINË

Figura 3 - Regjistrimi

2.2. Konfirmimi dhe plotësimi i profilit

Pasi aplikuesi të ketë klikuar në butonin Krijo llogarinë, do të hapet një faqe informuese e cila do të lajmërojë edhe njëherë se në cilën E-mail adresë do të konfirmojë llogarinë e krijuar, (Fig. 4), si dhe që konfirmimi duhet të bëhet brenda 24 orëve.



KONFIRMONI E-MAILIN

Një E-mail është dërguar në example@example.com

Ju lutem kontrolloni Inbox-in e E-mailit tuaj (gjithashtu shikoni në ndonjë "junk" apo "spam folder" që mund të keni) për një E-mail nga ne. Ky mesazh do të përmbajë një buton për të konfirmuar që E-mail adresa example@example.com është në pronësinë tuaj, për të verifikuar llogarinë tuaj në sistemin tonë dhe të vazhdoni me kompletimin e profilit tuaj.

Konfirmimi duhet të bëhet brenda 24 orëve. 

Figura 4 - Konfirmimi i E-mail

Në rast se kanë kaluar 24 orë, apo nuk është pranuar ndonjë E-mail për konfirmim brenda 24 orëve, aplikuesi mund të shkojë te faqja e **Kyçjes** (Fig. 2), ku mund të shkruan E-mail adresën dhe Fjalëkalimin (nr. 2), e cila do të hap përsëri faqen informuese me butonin **Dërgo përsëri email** për konfirmim.



Figura 5 - Dërgo përsëri E-mail

Një E-mail konfirmues do të duket si në figurën më poshtë:




Figura 6 - Konfirmo llogarinë

Për të konfirmuar llogarinë, duhet të klikoni në njërin nga linqet të cilat janë të shënuara me shigjetë (Fig. 6), si dhe duhet pasur kujdes që konfirmimi të bëhet brenda 24 orëve.

Më pas do të hapet një faqe ku duhet plotësuar fushat e tjera për të përfunduar regjistrimin.

Që profili të krijohet me sukses ju duhet që të plotësoni të gjitha fushat të cilat janë të obligueshme (*), ndërsa fushat që nuk kanë * janë opsionale për tu plotësuar.


Numri personal, E-mail adresa si dhe lloji i llogarisë janë fusha të cilat nuk mund të ndryshohen më.

Përveç tjerash, aplikuesi është i obliguar të ngarkoj dy dokumente për llogarinë individuale: numrin personal (në të dy anët) apo pasaportën, si dhe certifikatën e llogarisë bankare. Për llogarinë biznesore apo OJQ, duhet numrin personal apo pasaportën, certifikatën e llogarisë bankare, certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal. Dokumentet që ngarkohen nuk duhet të kalojnë madhësinë 5 Mb dhe duhet të kenë ekstensionin : jpeg, jpg, png, svg, gif, bmp, pdf, doc, docx, psd, ppt, pptx, xls, xlsx, txt, zip.

Në Figurën 7 mund të shihni formën e plotësimit të profilit me llogari individuale, ndërsa te Figuar 8 mund të shihni formën e plotësimit të profilit për llogarinë biznes, por që e njëjta përdoret edhe për OJQ.

Për të përfunduar procedurën e regjistrimit duhet të konfirmoni të dhënat e plotësuar, duke klikuar në butonin: *Unë konfirmoj saktësinë e informatave të dhëna dhe marrë përgjegjësi të plotë për dokumentet e bashkangjitura.*

Pas konfirmimit klikoni në butonin Ruaj.



KOMUNA E PRISHTINËS BALLINA KALENDARI LEGJISLACIONI NDIHMA KONTAKTI Shqip Regjistrimi Kycja

PLOTËSIMI I PROFILIT

JU LUTEM, PLOTËSONI PROFILIN TUAJ ME POSHTË

* Emri * Mbiemri

Numri personal

Lloji i llogarisë Individual E-mail i llogarisë

* Gjinia ☐ M ☐ F * Data lindje

Niveli i edukimit * Profesion

* Shtetësia

* Adresa

* Komuna * Kodi postar

* Telefoni

* Banka * Numri i llogarisë

* Emri i llogarit mbajtësit

Ngrani dokumentet e obligues

* Letërnjoftimi ose pasaporta No file chosen Madhësi maksimale: 5Mb


* Certifikata për llogar bankare No file chosen Madhësi maksimale: 5Mb

☒ Unë konfirmoj saktësinë e informatave të dhëna dhe marrë përgjegjësi të plotë për dokumentet e bashkangjitura.

Pushat me * janë të obligues!

RUAJ

Figura 7 - Plotësimi i llogarisë individuale



DU LUTEM, PLOTËSONI PROFILIN TUAJ MË POSHTË

* Emri * Mbiemri

Numri personal

Udhëzues i llogaritë Biznes E-maili i llogaritë

* Emri i biznesit * Adresa

* Komuna * Kodi postar

* Numri i regjistrimit * Numri fiskal

* Numri kontaktues * E-maili i biznesit

* Udhëzues

* Banka * Numri i llogaritë

* Emri i llogaritë mbajtës

* Numri i përgjithshëm i punëtorëve

* Numri i punëtorëve femra * Numri i punëtorëve meshkuj

Ngratëni dokumentat e obliguar:

* Letërnjoftimi ose pasaporta * Certifikata për llogaritë bankare

* Certifikata e regjistrimit * Certifikata e numrit fiskal

* Keni marrë saktësinë e informatave të dhëna dhe marrë përgjegjësi të plotë për dokumentat e bërë

Rushtat me "jani të obliguar"

RUAJ

Figura 8 - Plotësimi i llogaritë së biznesit / oj

2.3. Kyçja

Për tu kyçur me llogaritë duhet të klikoni në menu **Kyçja** – e cila është paraqitur në Figurën 2, ku nr. 2 e keni të paraqitur hapësirën ku fillimisht shkruani E-mail adresën me të cilën jeni regjistruar dhe fjalëkalimin. Me pas klikoni butonin KYÇU (nr. 3).

2.4. Rivendos fjalëkalimin

Nëse keni harruar fjalëkalimin e vendosur, klikoni në butonin “Keni harruar fjalëkalimin?” (shih Figurën 2, nr. 4).



E-MAILI JUAJ

RIVENDOS FJALËKALIMIN E RI

Figura 9 - Keni harruar fjalëkalimin

Pasi të hapet faqja si më lartë, mund të shkruani E-mail adresën se për cilën llogari keni harruar fjalëkalimin. Më pas klikoni në butonin “Rivendos fjalëkalimin e ri”, pas të cilit do të ju vjen një E-mail njoftues që duhet të kontrolloni emailin.

Përshendetje,

Ju sapo keni kërkuar rivendosjen e fjalëkalimit të ri për llogarinë tuaj grant.appdec.com në <http://grant.appdec.com>

Për ta rivendosni fjalëkalimin ju lutem klikoni [këtu](#) apo në linkun më poshtë:

<http://localhost:48535/Account/ResetPassword?userId=4d602e41-a85a-4e0c-a225-38df56f93c9b&code=CfDJ8Cqvmduak5pEg2dLfHmJNf5Ze7SdympIc%2F5ESURbhGiUaLWNL0iNQhMBCHfhvX4mpZqd8lq%2B6pdfhEXubC7WMveOFC0JBXyFm0Dg0t5Y8VWLva1WX0CeU8Yis1FzZivT%2BmRK0XERoPgkZPEQugECkip4jSrvW1qfCBdp1Q02yz6fALYZMzaDm%2FKzAGo673fpdngtPUSWBCRy55YDqzv1Wf3HRieBut5vkhHnFAl5rS6DzaSiGsSW%2BTeNgLIroPg%3D%3D>

Ky është një email automatik nga sistemi <http://grant.appdec.com>. Në qoftë se nuk do të duhej ta pranoni, ju lutem e injoroni këtë email.

Komuna e Prishtinës.

Figura 10 - Linku për rivendosje të fjalëkalimit

Në Figurën 10 – mund të shihni dy linke ku mund të klikoni për ta ndryshuar fjalëkalimin e llogarisë. Këto linke do të ju dërgojnë në faqen ku do të mund të shkruani E-mail adresën, fjalëkalimin dhe konfirmimin e fjalëkalimit, (Fig. 11).



RIVENDOSJA E FJALËKALIMIT TUAJ

Email adresa

Fjalëkalimi

Konfirmo fjalëkalimin

Rivendos

Figura 11 - Rivendos fjalëkalimin